



KOMUNIKATË

23.12.2009

Në mbledhjen e 84-të me radhë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shqyrtoi agjendën lidhur me aktivitetet e hetimit dhe të rinumërimit të fletëvotimeve të Raundit të Dytë të Zgjedhjeve për Komunën e Gjilanit, informatën për aktivitetin e procesit të rivotimit për Raundin e Dytë në Komunën e Prizrenit dhe të Lipjanit dhe, informatën nga QNR. Përpara se të miratohej rendi i ditës, Kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, propozoi që në rend të ditës të hyjë edhe rekomandimi i KZAP-it për Këshillat e Vendvotimeve në komunat ku do të përsëriten zgjedhjet për kryetar të komunave.

KQZ pasi që e ka miratuar rendin e ditës, ka shqyrtuar fillimisht përgatitjet për ripërsëritjen e votimeve në Prizren dhe Lipjan. Kryeshefi i SKQZ-së, z. Xhemajl Peqani, e informoi KQZ-në për gadishmërinë e Sekretariatit që t'i përgatisë me kohë planin operacionz zgjedhor për komunën e Prizrenit dhe Lipjanit dhe t'i implementoj ato. Hetimi dhe rinumërimi i votave në QNR për komunën e Gjilanit, do të filloj të hënen nëse gjathcka shkon sipas planit. Hetimi dhe rinumërimi, do të bëhet në bashkëpunim me Aifes-in, me subjektet partiake, me vëzhguesit, mediat etj.

Sa i përketë asaj se kur do të mbahet rivotimi për këto dy komuna, Kryeshefi Xhemajl Peqani, tha se orientimisht mund të jetë data 24 janari, i vitit të ardhshëm. Është duke u përgatitur draft-plani operacional, ku do të shihet se sa kohë do të na duhet për përgatitje. Kryetarja e KQZ-së, Nesrin Lushta, tha se, ne do të veprojmë ashtu siq kemi vendosur: me hetim dhe rinumërim në Gjilan. Në rast se hetohen shkelje të rënda, do të vendoset të shkohet në rivotim.

Anëtarët e KQZ-së, kanë vlerësuar që hetimi dhe rinumërimi për komunën e Gjilanit të fillojë mundësisht të hënen, kurse nuk kanë marrë vendim që rivotimet për Prizren dhe Lipjan të mbahen me datën 24 janar, deri sa SKQZ të kompletojë planin operacional.

Kryeshefi i SKQZ-së, e ka informuar KQZ-në se, një pjesë e materialit teknik do të mund të përdoret nga zgjedhjet e kaluara. Sipas propozimit të

Kryetares Lushta, në mbledhje u folë edhe për ndryshimin e KVV-e, shtimin e prezencës së Policisë së Kosovës në Qendrat e Votimit dhe, KQZ të shtoj mbikqyrjen gjatë procesit të votimit. Kryeshefi Peqani, tha se ndryshimi i KVV-e përbën sfidë, sepse udhëzimit të KZAP-it, duhet të ndryshohen të gjitha. Mirëpo, SKQZ do t'i zhvillojë aktivitetet e veta në bazë të draft-planit dhe, do të bëj përgatitjet me sukses.

KQZ mori vendim për ndryshimin e të gjitha Këshillave të Vendvotimeve (KVV) në Prizren dhe Lipjan,

Kordinatori i Qendrës së Numrimit dhe Rezultateve, z. Burim Ahmetaj, e informoi KQZ-në për përfundimin e numërimit të votave me kusht. Edhe në komunën e Rahovecit, ka përfunduar ky proces. QNR praktikisht, e ka përfunduar procesin e numërimit të votave me kusht për 18 komuna.